

INTERVISTË ME MAHMUT MUMCI

Prishtinë | Data: 8 dhjetor, 2018

Kohëzgjatja: 77 minuta

Të pranishëm:

- Mahmut Mumci (I Intervistuari)
- Ebru Süleyman (Intervistuesja)
- Donjeta Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Ebru Süleyman: Mirë se erdhët.

Mahmut Mumci: Mirë se ju gjeta, faleminderit. Me sa e kuptova unë, ju dëshironi ta realizoni një intervistë me mua. Për fillim dua t'ju jap disa të dhëna për veten time. Në fakt unë zyrtarisht i kam dy emra, edhe Mahmut edhe İdris. Kjo është e lidhur me lindjen time, në kohën kur jam lindur, para meje ka qenë një vëlla İdrisi, por ai vdiq, prandaj që të mos përsëritet i njëjti emër ata ma lanë emrin Mahmut İdris, por pasi që nuk dëshironin ta përmendin emrin e vëllaut të vdekur më kanë thirrur me emrin e parë, vetëm Mahmut. Nuk po ju lodhi shumë me emra, por unë vetëm pasi e përfundova shkollën fillore e kuptova këtë tregim lidhur me emrin tim.

Për t'u regjistruar në gjimnaz është dashur ta nxjerr çertifikatën e lindjes në komunë, në asnjë letër nuk u gjet [emri], por për fat të mirë një fqinj i joni punonte si nëpunës civil, Şeraffettin Salih. Ai pas një kohe tha, "Prit bre prit, ti nuk je İdrisi" tha, "İdrisi ka vdekur". "Tani" tha, "unë ty do të të gjej, nuk je ti Mahmuti" hyri te regjistrat dhe aty e gjeti, "Ti je İdrisi", saktë e gjeti datën, kështu e rregulluam këtë punë. Para se të regjistrohesha në gjimnaz e kuptova që nuk isha Mahmuti por İdrisi. Këtë punë e rregulluam por gjatë jetës sime gjithmonë jam përballur me dy emra. Të gjithë të afërmit, shokët, kushërinjtë më kanë njohur si Mahmut, por zyrtarisht e kam emrin İdris.

Ebru Süleyman: Kjo ju përkujton familjen?

Mahmut Mumci: E vërtetë. Unë pastaj u interesova, përse u bë kështu, dhe siç ju tregova më parë, ato ishin arsyt. İdris, vetëm İdris e regjistroi xhaxhai im, emrin e babait të tij, domethënë me qëllim që emrin e gjyshit tim ta ripërtërijë e ka regjistruar vetëm emrin İdris e Mahmut fare nuk e ka shkruar. Nejse, kjo ngjarje ka ndodhur më 10 shtator 1947, sepse ajo është data e lindjes sime, ditëlindja.

Unë jam lindur këtu në Prishtinë, në një familje tregtarësh. Babai im, gjyshi dhe paraardhësit e tyre janë marr ose me zeytari ose me tregti. Babai im është marr edhe me tokë edhe me zeytari. Kemi pasur toka, kemi pasur bagëti. Ai stil i vjetër i jetës ka zgjatur deri në vitin 1968. Pastaj në Prishtinë ka dalur ligji që të mos mbahen bagëtitë në shtëpi, kështu që i kishin larguar. Ka vazhduar punën vetëm në

dyqan, si saraç¹ për të fituar dhe për t'i rritur fëmijët.

Ebru Süleyman: Domethënë ai ka qenë saraç?

Mahmut Mumci: Babai ka qenë saraç. Si fëmijë, mbaj mend që Prishtina ishte një vend i njohur për zejtarë. Sipas disa të dhënave, në atë kohë kishte 250 dyqane zejtarësh, në pazar profesionet më të zakonshme në treg ishin saraçët, këpucëtarët dhe rrobaqepësit. Familja e shquar e saraçëve ishte familja jonë Mumci. Ndërsa familja e shquar për këpucëtar ishte familja Sraja, ata kishin të paktën katër ose pesë dyqane.

Ebru Süleyman: E a mund të shpjegoni për njerëzit që nuk e dinë çka do të thotë saraç? Çka është ky zanat?

Mahmut Mumci: E tani, ky zanat i saraçit është një zanat që merret me kafshët. Me fjalë të tjera, saraçi është ai që siguron dhe bën pajisjet e nevojshme (buzëqesh) që kafshët të vrapojnë. Ata përdorin lëkurë në punën e tyre. Ata bëjnë jakën e qafës, unazën dhe shalën, ato që përdoren për të hipur në kuaj. Kapistër dhe litar, ata kishin gjithçka që ju nevojitej. Në fakt, kam kaluar shumë kohë të fëmijërisë sime si ndihmës në dyqanin e babait tim. Epo, nuk isha aty tërë kohën, derisa isha në vitin e tretë të universitetit e ndihmoja babanë në dyqan.

Pasi dola në vitin e tretë u bë e qartë cilën rrugë do ta zgjedh. Më shumë se gjysma e ligjëratave të fakultetit mbaruan. Isha një student mjaft i suksesshëm. Për këtë arsye patjetër është dashur të largohem nga dyqani. E vazhdova universitetin. Pasi që isha një student i suksesshëm në universitet, e kam fituar bursën prej universitetit. Në të njëjtën kohë, unë isha duke punuar si asistent në Degën e Histologjisë. Unë kam qenë me fat që gjithçka shkoi mirë në vitet e fundit të universitetit, kështu që kurrë nuk kam pasur probleme financiare. Gjatë asaj kohe, profesioni i saraçëve pothuajse kishte mbaruar. Për shkak se qerret, kuajt dhe bagëtitë ishin të ndaluara në Prishtinë, kjo ishte arsyeja pse nuk kishte më nevojë për saraçë.

Ebru Süleyman: A ju kujtohet gjyshi juaj? Gjyshi İdris.

Mahmut Mumci: E tani nëse flasim për trungun familjar (buzëqesh) nuk e mbaj mend gjyshin tim, por për shkak se jam i interesuar për këto gjëra, e di se unë jam brezi i shtatë i familjes time. Sipas informacionit që e kam arritur ta kem, unë jam brezi i shtatë i familjes që jeton në Prishtinë. Pas meje, janë fëmijët e mi, kështu që mund të them që kemi tetë breza të historisë këtu në Prishtinë. Më saktësisht, prej ku kanë ardhur këtu nuk e di. Ka tregime të ndryshme por e di që tetë gjenerata jemi këtu në Prishtinë.

Ebru Süleyman: Domethënë tetë gjenerata jeni në Prishtinë?

¹ Zejtar që merret me punimin e sendeve prej lëkure e meshini, si rripa, takëme kuajsh, këllëfë etj.

Mahmut Mumci: Po. Babai im ishte Mehmeti, babai i Mehmetit ishte İdrisi, domethënë emrin zyrtar që e kam prej tij. Edhe babai i İdrisit e kishte emrin Mehmet, ndërsa babai i atij Mehmetit ka qenë Aguşi. Pas Aguşit është edhe një Ahmet. Kështu nëse i rendisim, unë jam gjenerata e shtatë.

Ebru Süleyman: E nëna?

Mahmut Mumci: Edhe nëna rrjedh prej një familjes së vjetër prishtinase. Në fakt nëna vjen prej një familje të përzier. Babai i nënës sime në fakt është nga Gjakova... ku mbetëm? Siç thash babai i nënës është me prejardhje nga Gjakova, kurse ana e nënës [gjyshes] nga Prizreni. Zonja Bercüzan, si nuse ka ardhur në Prishtinë në vitin 1907.

Ebru Süleyman: 1907-tën?

Mahmut Mumci: 1907-tën. Në fakt familja e nënës sime është nga Shkupi. Babai i saj Sadik, gjyshi Hayrullah, ata në vitin 1904, apo edhe më herët prej Shkupit kanë ardhur dhe janë vendosur këtu, në Prishtinë.

Ebru Süleyman: Ju keni lindur në vitin 1947, domethënë 1950-tën periudhën e fëmijërisë tuaj e keni kaluar në Prishtinë. A ju kujtohet ajo periudhë? Lagjet?

Mahmut Mumci: Si s'më kujtohen, si s'më kujtohen?! Shtëpia jonë ka qenë në një lagje të vjetër në Prishtinë, i thonin lagjja "Yeni Meytepler" [Shkollat e reja] sepse rruga ka qenë afër shkollës së vjetër "Vuk Karaxhiq". Madje asaj rruge i thoshin lagjja "Kanlilar". Dhe pikërisht para shtëpisë së familjes Kanlilar ka qenë një hapësirë e madhe.

Ebru Süleyman: Cila shtëpi është ajo e familjes Kanlilar?

Mahmut Mumci: Përball neve, më poshtë shtëpisë së Sunës. Aty ka qenë një hapësirë e madhe i thoshin "Narka". Të gjithë fëmijët e lagjes mblidheshim aty. Në të gjithë rrugën asnjë i huaj s'ka qenë. Të gjithë ishin prishtinas, me prejardhje turke. Ka qenë vetëm një familje serbe nga Mali i Zi. Si sot e mbaj në mend, në rrugën tonë pasi i kaloje shkollat në anën e djathtë fillimisht ka qenë Abdurahmani dhe vëllau i tij, ata kanë qenë këpucëtar. Pastaj në vitet e '50-ta, '56-'57-tën kanë emigruar në Turqi. Fqinji i tyre ishin Kemal Şaban, njëri prej drejtorëve të fundit të shkollës "Meto Bajraktari". Njëri prej drejtorëve të fundit të shkollës turke... Kemal Şabani i kishte edhe dy vëllezër. Naimi, ishte poet i yni që vdiq, poet, poet i fëmijëve. E kishte edhe një vëlla Ahmet.

Pas këtyre shtëpive, ka qenë një familje që erdhi nga Janjeva dhe u strehua këtu, familja Bikliç, xhaxhi Hasim. Mbi shtëpinë e tyre ishte tetoja Cüzade. Tetoja Cüzade ishte një grua që mbeti herët e ve, ajo i kishte dy vajza, Haticen dhe Hamdiyen. Shumica prej këtyre njerëzve nuk janë të gjallë, kanë vdekur.

Vetëm e bija e kësaj zonjës Cüzade, Hamdiya është në Prishtinë, por nuk është në atë lagje, në atë shtëpi. Mbi ta, ishin zotëri Şemsi dhe zonja Şükriye që jetonin së bashku. Fëmijët e tyre ishin Faruk, Celal dhe Süvey. Süvey ishte farmacist, ai gjithashtu ndërroi jetë. Celal dhe Faruk janë akoma në Prishtinë, por jo në shtëpinë e tyre të vjetër, ata u zhvendosën diku tjetër. Pas tyre, ishte xhaxhai i zotëri Şemsit, zotëri Ahmeti. Zotëri Ahmeti gjithashtu kishte katër fëmijë, djem. Njëri prej tyre vdiq në luftë, në fakt ai ishte një hero i luftës...

Ebru Süleyman: Në cilën luftë?

Mahmut Mumci: Në Luftën e Dytë Botërore, derisa ishte duke luftuar si partizan, ai u vra në vitin 1943, emri i tij ishte Zeynel. Vëllezërit e tij të tjerë... Kemali dikur ishte zdrukhtar. Po ashtu ka qenë një vëlla tjetër Bedriu, ai gjithashtu ka qenë zdrukhtar, si dhe ka qenë Şerafetdin. Şerafetdini është ai që e përmenda më herët, ai që punonte si nëpunës civil në komunë, i cili gjeti të dhëna dhe gjeti emrin tim zyrtar. Mbi neve ka qenë xhaxhi Faik. Edhe ai ka qenë këpucëtar, edhe ai emigroi në Turqi. Pas tyre ishte shtëpia e Maçkalar. Kanë qenë Maçkalarët, zonja Cemile dhe zonja Vezire. Këto dyja ishin dy motra, njëra jetonte në katin e parë, tjetra në katin e dytë, i kanë pasur shtëpitë e mëdha, të vjetra.

Ebru Süleyman: Në atë kohë a ka qenë e tërë lagjja ashtu? Me shtëpi të vjetra?

Mahmut Mumci: Ashtu, ashtu të gjitha.

Ebru Süleyman: Tani ku është "Elena Gjika" aty afër...

Mahmut Mumci: Ajo shtëpia e Koxhadishëve...

Ebru Süleyman: Domethënë i kanë përngjarë shtëpisë së Koxhadishëve?

Mahmut Mumci: Pak më të vogla, jo aq të mëdha por kishte shtëpi që i përngjanin asaj. Edhe ashtu në atë rrugën tonë kanë mbetur vetëm dy shtëpi të vjetra. Njëra është shtëpia e tezës Cüzade, nipi i saj Pleorati jeton aty. Si dhe në fund të rrugës në një kënd e Şaçirit, shtëpia e të ndjerit Şaçir Toygar, nëna e tij ka qenë zonja Çamile. Dhe njëri djal i Şaçirit, tani aty ende jetojnë bashkëshortja Şaçirit dhe fëmijët e tij. Emel, Abdülrahman, Ercan ata edhe sot e kësaj dite jetojnë aty.

Ata janë në pjesën e djathtë të rrugës. Tani nëse shkoni përsëri në të njëjtin drejtim në anën e majtë, shtëpia e parë ishte shtëpia e familjes Tanik. Ata ishin gjithashtu dy vëllezër zejtarë, Haliti dhe vëllai i tij që punuan si këpucëtar. Kishin një dyqan këpucësh. Poshtë tyre ishte shtëpia e Zaimit. Ata janë akoma duke jetuar aty, ata nuk lëvizën, shtëpia e tyre e vjetër dikur kishte një kopsht me të vërtetë të madh, dhe ishte vërtet interesante, por për fat të keq ata e shkatërruan shtëpinë dhe e ndërtuan një të re. Xhaxha Fetah dhe Ferati dikur jetonin aty.

Ebru Süleyman: E çka ka qenë interesante për atë shtëpi, arkitektura a?

Mahmut Mumci: Për sa i përket arkitekturës, më kujtohet sidomos kur ishim të vegjël, shkonim atje si fëmijë dhe kishte dekorime shumë interesante në tavan, por sa keq që është zhdukur tani, të gjitha kanë ikur... Poshtë tyre ishte shtëpia e zotëri Hayrullahut, i cili ishte njeri i fesë, hafëz². Ai kishte një personalitet të qetë. Ai gjithashtu kishte dy djem, Ismailin dhe Ibrahimin. Të dy vdiqën. Ai e ka një nip Vedatin, shtëpia prapë u takon atyre, por ata po jetojnë në Turqi. Ata dikur vinin dhe shkonin, por kohët e fundit i kanë ndaluar vizitat në shtëpinë e tyre.

Ebru Süleyman: Fëmijërinë e keni kaluar në këtë lagje?

Mahmut Mumci: Në këtë lagje. Shumë shokë i kisha aty. Nëse fillojmë prej lartë, fillimisht kanë qenë janjevasit Atif, Edip, Erdem, Mazhar, İsaku. Këta të gjithë ishin prej një shtëpie. Pastaj, mbi ta ishte një familje shqiptare që jetonte në rrugën tonë, Vrshevcët. Skender Vrshevc, në të vërtetë, ata ende janë duke jetuar aty, edhe ata u vendosën aty sa që edhe me ta flisnim vetëm turqisht. Edhe sot, (buzëqesh), ne ende flasim turqisht, ne jemi të vetmit që nuk lëvizëm prej andej. Gjithashtu ka fqinjë të Skenderit dhe Nozanit që jetojnë aty, nipërit e xhaxhait Aliş.

Kurse më lartë, pas asaj lagjes Kanlilar që e përmenda, në atë hapësirë kanë qenë dy familje. Familja Binçe, disa prej tyre ende jetojnë aty. Kemali, Ümrani dhe İskederi. Dhe i kanë motrat Masume dhe Suzan, ato tani jetojnë në Danimarkë. Kemali ka qenë shok i imi i shkollës. Kështu... ata janjevasit që i përmenda, ata të gjithë emigruan në Turqi. Prej tyre ishte xhaxhai Hakkı, gjyshi i Mazharit, që ishte moshatar i imi dhe shok i klasës.

Ebru Süleyman: Në cilat vite kanë shkuar ata?

Mahmut Mumci: Ata [kanë shkuar] 1956-tën. Emigrimi ka filluar në vitin '55, që nga viti '55, emigrimi drejt Turqisë ka filluar në vitet, '55, '56, '57 këto tre vite kanë qenë më intenzive. Është shumë interesante, e kam një fotografi nga shkolla fillore aty janë diku 40 nxënës. Vetëm 12 prej atyre 40 nxënësve kanë qëndruar këtu, dhe gjithë të tjerët kanë emigruar në Turqi.

Ebru Süleyman: Në cilin vit e ke filluar shkollën?

Mahmut Mumci: Shkollën e kam filluar në vitin 1954.

Ebru Süleyman: Pra, në vitin '54, 40 nxënës ishin në një klasë.

Mahmut Mumci: Më shumë se 40 nxënës. Klasa e parë ishte nga viti '54 deri '55. Ne ishim më shumë se 40 nxënës në vitin '54, ndoshta 42 por në vitin '55 pas emigrimit, në klasë të dytë, numri ishte ndoshta i

² Person që e di përmendësh tekstin e Kuranit, të cilin ua thotë besimtarëve gjatë shërbimeve fetare.

përgjysmuar. Nuk e di saktësisht se sa shumë prej tyre kanë mbetur dhe i njoh vetëm ata që kanë qëndruar këtu. Unë për herë të parë u regjistrova në shkollën fillore “Meto Bajraktari”, shkolla sapo ishte hapur dhe nuk kishte 40, por edhe më shumë studentë aty. Mësuesi im i parë ishte Ismail Siçan ose Aksoj. Ata kishin dy mbiemra, por nga familja e Siçanëve. Një ditë, njëri nga mësuesit erdhi në klasën tonë, ata bënë një listë bazuar në atë se ku banojnë nxënësit dhe duke u bazuar në atë listë gjysma e klasës u zhvendos në “Vuk Karaxhiq”.

Ebru Süleyman: Pra, ju e filluat shkollën në “Meto Bajraktari” dhe e vazhduat në “Vuk Karaxhiq”.

Mahmut Mumci: Po, po. E kompletova klasën e parë atje. Për nxënësit e klasës së dytë ata e hapën një klasë në gjimnaz, në shkollën e mesme të tanishme “Sami Frashëri”, e cila quhej “Milladin Popoviq” atëherë. Kemi përfunduar klasën e dytë në atë ndërtesë. Ne patëm dy mësues atë vit, njëri prej tyre Naim Şaban, ai më vonë u bashkua me ushtrinë, dhe zonja Behice vazhdoi pas tij. Dhe në vitin e tretë, ata ndryshuan gjithashtu ndërtesën e shkollës dhe e çuan të gjithë klasën në Shkollën Teknike të vjetër, atë e quajtëm “Lovac”, në një ndërtesë të vjetër që aktualisht është Arkivi i Komunës. Është një objekt që u ndërtua gjatë sundimit osman.

Ebru Süleyman: Ajo ndërtesa e bardhë e arkivit, ku është Shkolla Teknike tani?

Mahmut Mumci: Po, ndërtesa e arkivit atje. Emri i shkollës në atë kohë ishte “Milladin Popoviq”, dhe unë e përfundova klasën e tretë dhe të katërt atje. Mësuesja jonë ishte mësuesja Müberra, ajo ishte nga Mitrovica, por burri i saj ishte një politikan dhe ata ishin caktuar për detyrë në Prishtinë kështu që ajo u bë mësuesja jonë. Pas kësaj, shkova në “Meto Bajraktar” për klasën e pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetën. Pas kësaj, shkolla e mesme dhe pastaj universiteti.

Ebru Süleyman: E në vitin ‘55 që filluan emigrimet, në vitet ‘55 - ‘56 janë shpërngulur më shumë, pse njerëzit prej këtu shkonin në masë aq të madhe?

Mahmut Mumci: Pasi që ne atëherë ishim shumë të rinj nuk i kuptonin saktësisht arsyet. Me siguri na e ka marr mendja nga pak përse edhe ata po shkojnë, por sipas të dhënave u pa që arsyeja kryesore ishte presioni që po ju bëhej. Në atë kohë ishte një ngjarje që shumicës ia ka nxirë jetën. Ata thoshin që gjoja ka disa familje që fshehin armë në shtëpinë e tyre, dhe ata me dhunë hynin nëpër shtëpitë e familjeve për të mbledhur armë. Njerëzit tonë vuajtën shumë këtu. Me dhunë fizike, me para, nuk mundën më ta durojnë këtë presion dhe detyrimisht janë larguar. Kanë pyetur, “Përse Turqia?” Sepse tjetërkush nuk i ka pranuar, sepse atëherë nuk kanë emigruar vetëm turqit, në mesin e atyre që kanë shkuar në Turqi ka pasur edhe familja shqiptare, Turqia i ka pranuar edhe ata. Tani këtu, sipas disa të dhënave, gjoja ka ekzistuar një marrëveshje midis Jugosllavisë dhe Turqisë, dhe bazuar në këtë marrëveshje, Turqia i kishte pranuar të gjithë emigrantët. Ata ishin pothuajse të detyruar të shpërnguleshin, njerëzit shisnin të gjitha gjërat e tyre ose braktisnin shtëpitë e tyre dhe migruan pothuajse plotësisht të zhveshur.

Ebru Süleyman: Shumica e familjeve kishin toka dhe gjëra por të gjitha ato i mori shteti.

Mahmut Mumci: Po, të gjitha i mori shteti dhe ky është njëfarë presioni. Ata e ndërprejnë stilin e jetës së tyre me forcë, për shembull ferexhja³ ishte një traditë në atë kohë dhe ata e ndaluan veshjen e saj. Në shkollë kishte presion mbi fenë, me qëllim që njerëzit të largoheshin nga feja, xhamitë ose ishin kthyer në qendra tregtare ose ishin duke u mbyllur.

Ebru Süleyman: E atëherë në fillim të viteve të '50-ta si visheshin njerëzit? A kishin ferexhe?

Mahmut Mumci: Për besë, mua sa më kujtohet, deri në vitin '51 - '52 zonjat në Prishtinë kanë ecur me ferexhe. Në mesin e tyre rrallë kishte edhe të pa mbuluar, por vendaset zakonisht mbanin ferexhe. Pastaj '51-'52-tën i hoqën, i ndaluan ferexhet. Ferexhet i hoqën, vetëm kush donte e mbulonte kokën. Pastaj, kur vështrojmë ngadalë situatën në shkollë, tani mund t'i kuptojmë disa presione për të cilat nuk dinim atëherë. Për shembull, përveç lëndëve të tjera, e kemi pasur gjuhën serbe si lëndë të detyrueshme, pothuajse çdo ditë në javë, të paktën tri orë. Po ashtu, nëse keni pasur notë të keqe në gjuhën serbe, ishte e detyrueshme që të përsërisni vitin. Do ta humbisnit një vit vetëm sepse nuk e dinit mirë gjuhën serbe.

Ebru Süleyman: Pra, orët zakonisht mbaheshin në gjuhën turke, por gjuha serbe ishte shtesë.

Mahmut Mumci: Në shkollë fillore e kishim vetëm një orë të gjuhës serbe. Të tjerat ishin në turqisht. Pasi që e kishim vetëm një mësues, ne shpesh bënim orë mësimi në gjuhën serbe sepse gjoja nuk kishte personel të mjaftueshëm për mësim në gjuhën turke. Për shembull mësuesit serbë na jepnin lëndë si, kimia, fizika, arti, në atë kohë e kishim edhe një lëndë të quajtur bukurshkrim, që gjithashtu na jepnin mësuesit serbë.

Ebru Süleyman: Me siguri sa keni qenë i vogël keni dal në lagje për të luajtur. A ju kujtohen këto?

Mahmut Mumci: Sigurisht, fëmijët që nuk luajnë në rrugë (buzëqesh), nuk ka diçka të tillë, kemi luajtur rreth e rrotull në lagjen tonë me fëmijët, kemi luajtur lojëra të ndryshme. Kemi luajtur fshehurazi (buzëqesh), kemi luajtur një lojë të quajtur "fanta" me mermer, ose ndonjëherë kemi përdorur arra për ta luajtur atë lojë. Pastaj ishte një lojë e quajtur "pesë gurë", e gërmonim një vrimë dhe hidhnim gurë në atë vrimë nga distanca, ai që mund t'i hidhte të gjithë gurët në vrimë e fitonte lojën. Pastaj ishte një lojë e quajtur *derecik* [turqisht - lumi i vogël], ne e luanim atë. Hidhnim karbide për ditë të veçanta si Bajrami ose Ramazani. Gërmonim një vrimë në Narka, që e përmenda më parë. Vendosnim një konzervë aty dhe e mbushnim atë me karbid në mënyrë që të bënte një tingull kur shpërthente...

³ Robë e zezë, me të cilën gratë myslimane mbulonin fytyrën dhe trupin kur dilnin nga shtëpia.

Ebru Süleyman: E karbidi çka është?

Mahmut Mumci: Karbid është barut, domethënë diçka si barut i papërpunuar. Kështu i thoshim shpërthim i karbidit. Atëherë shpesh fëmijët e lagjes bashkoheshim dhe silleshim vërdallë. Shkonim në Taukbahçe, në Gërmë. Para Taukbahçes ishte një vend që i thoshim “*Strelishtë*”, zona e zjarrit. Në atë kohë aty ishte edhe vendi i *teferiçit* [piknikut] të qytetarëve, shpesh dilnin aty te fusha, fushë i thoshin. Atëherë në Prishtinë kishte katër vende për piknik, ajo fusha, e dyta Taukbahçja, e treta Gërmia si dhe e katërta sot që i themi Dragodan, aty i thoshim vreshtat e romëve, edhe aty dilnin për piknik familjet.

Ebru Süleyman: E çfarë bënit në *teferiç*?

Mahmut Mumci: *Teferiçi* është sikur pikniku i kohës së sotme moderne, domethënë si piknik. Përgaditeshin ushqimet, ushqimet që mund t’i merrje me vete, pihej çaji, kafja.

Ebru Süleyman: Çaji atëherë pihej prej *samovarit*⁴ apo jo?

Mahmut Mumci: Prej *samovarit*, madje edhe zjarrin e ndiznim. Unë sa e mbaj në mend çaji pihej në çdo shtëpi, të pakten një herë në ditë. Varet edhe kur vinin mysafirët, por zakonisht pihej një herë në ditë, po. Në atë lagjen tonë secila shtëpi i kishte kopshtet e mëdha. Në ato kopshte mbilleshin lule dhe drunjë të ndryshëm. Pastaj në mesin e këtyre bënin *çüşk*⁵, aty uleshim, aty kënaqeshim (buzëqesh).

Ebru Süleyman: *Çüşk-u* në kopsht a?

Mahmut Mumci: Rregullohej, ndërtohej me dru, aty uleshim, në mes të kopshtit apo në ndonjë pjesë, por asnjë shtëpi nuk ka qenë pa kopsht, pa lule.

Ebru Süleyman: Domethënë qyteti më parë ka qenë shumë më i bukur.

Mahmut Mumci: Tani nëse i numërojmë në rrugën tonë deri në fund të shkollës, deri te rruga “Rijeka”, aty tetë dhe nga kjo anë edhe dhjetë {numëron}, 18 shtëpi kanë qenë, sot po t’i shikojmë 30 do të dalin. Kështu që, të gjitha kanë pasur kopshte të mëdha ku mund të rrinin rehat. Gjithashtu shtëpitë ishin të mëdha, nuk kishte shtëpi të vogla.

Ebru Süleyman: Pasi e përfunduat shkollën fillore e regjistruat gjimnazin?

Mahmut Mumci: Pas shkollës fillore u regjistrova në gjimnaz.

⁴ Enë prej metali zakonisht për çaj, me lëfyt dhe me një gyp të gjatë në mes që mbushet me prush.

⁵ *Çüşk, köşk*, shtëpi e vogël e zbukuruar brenda kopshtit

Ebru Süleyman: Ku e keni vijuar gjimnazin?

Mahmut Mumci: Në Prishtinë.

Ebru Süleyman: Por cilin gjimnaz?

Mahmut Mumci: Tani ky gjimnaz që po e mban emrin “Sami Frashëri”, aty jam arsimuar. Atëherë ka qenë “Milladin Popoviq”, pastaj ia ndërruan në vend të “Milladin Popoviq” ia lanë “Ivo Llolla Ribar”. Pastaj emri i fundit “Sami Frashëri”.

Ebru Süleyman: Gjatë gjithë kësaj kohë e keni vijuar gjimnazin si dhe i keni ndihmuar babait në dyqan?

Mahmut Mumci: Po, derisa e përfundova gjimnazin kam punuar si ndihmës në dyqanin e babait.

Ebru Süleyman: Ku ka qenë dyqani i babait tuaj?

Mahmut Mumci: Në Çarshinë e Vjetër.

Ebru Süleyman: Në Çarshinë e Mbyllur [*Kapali Carsia*] të Divan Jollit?

Mahmut Mumci: Eh Çarshinë e Mbyllur unë nuk e kam përjetuar sepse në vitet ‘46 - ‘47 e kanë rrënuar. Por ka të dhëna që ka qenë menjëherë poshtë xhamisë së Çarshisë.

Ebru Süleyman: Paska qenë poshtë xhamisë së Çarshisë?

Mahmut Mumci: Kur shkon drejt Divan Jollit, aty është një hapësirë. Kanë qenë tri rrugë {shpjegon me duar} të Çarshisë së mbyllur. Dhe në fund të asaj Çarshisë së Mbyllur paska qenë një shatërvan, pas shatërvanit edhe tri rrugica që shkonin drejt veriut, dhe aty kanë qenë të gjitha dyqanet e zejtarëve.

Ebru Süleyman: Ky shatërvan me siguri nuk ekziston më?

Mahmut Mumci: Jo, jo, jo. Ky shatërvan dikur ishte afër përmendores në sheshin kryesor. Unë mendoj se mbetjet e shatërvanit ishin aty deri në vitin 1960. Pastaj u bënë projektet e peizazheve. Për shkak të kësaj, pazari u rrënuar dhe nuk kishte asnjë gjurmë të skulpturave të vjetra. Sipas disa informacioneve, në Çarshinë e Vjetër, në Prishtinë kishte më shumë se 200 dyqane të zejtarëve. Të gjithë kishin vendndodhje specifike, për shembull, ishte çarshia e farkëtarit, e saraçit apo rrobaqepësit. Të gjithë kishin vendndodhje specifike.

Ebru Süleyman: Ku kanë qenë këta për shembull? Rrobaqepësit?

Mahmut Mumci: Rrobaqepësit... tani kur shkon në veri nga pazari në rrugën e parë, dikur ka pasur saraçë dhe këpuctarë. Përveç këtyre profesioneve, në rrugën e dytë, kryesisht kishte rrobaqepës. Dhe në rrugën e tretë ishte një dyqan “Uzor”. Ajo rrugë ishte rruga e litarpunuesve, aty ishin dyqanet e litarpunuesve.

Ebru Süleyman: E dyqani i babait tuaj që e përmendët, ku ndodhej brenda Çarshisë së Vjetër?

Mahmut Mumci: Në Çarshinë e Vjetër e kam kaluar fëmijërinë time si ndihmës, gjithashtu ata e quanin atë rruga e Çarshisë së Vjetër, më kujtohen pronarët e çdo dyqani. Tani është...

Ebru Süleyman: E ku i bie tani ajo?

Mahmut Mumci: Të vetmet objekte që kanë mbetur prej Çarshisë së Vjetër janë dyqanet poshtë ndërtesës së Parlamentit të Kosovës dhe Institucionit të Sigurimeve Shoqërore. Tani dyqani i parë është me bizhuteri, mendoj se i dyti është një avokat, pastaj është një kafene, sa e di Barişi i familjes Bölükbaş po e drejton atë. Ekziston vetëm një dyqan këpuctarësh që nuk ka ndryshuar kurrë, i përket familjes Straja. Pronari i fundit Irfani ka ndërruar jetë, tani ia kanë dhënë me qera njërit që po e vazhdon të njëjtin profesion.

Ebru Süleyman: Domethënë prej asaj Çarshisë së Vjetër vetëm ajo ka mbetur...

Mahmut Mumci: Prej asaj Çarshisë së Vjetër vetëm ai dyqan ka mbetur aty. Nga ana tjetër prej fillimit të Divan Jollit afërsisht të gjitha dyqanet janë aty por kanë ndryshuar pronarët dhe zanatet. Përballë këtyre dyqaneve ka qenë një *han*⁶, i thoshin *Bitli Han* [Hani i Morrave]. Afër rrugës “Bitli” ishte edhe “Bitli” shatërvani. Një pjesë e madhe e Çarshisë merrte ujë aty. Ose prej aty ose prej shatërvanit afër xhamisë së Çarshisë. Shatërvani i vjetër ende është aty.

Ebru Süleyman: A ju kujtohet ai *han*?

Mahmut Mumci: Më kujtohet, më kujtohet. Ai *han* u rrënua në vitin 1956. Në vend të saj e kanë ndërtuar atë objektin ku është tani ndërtesa e bankës “ProCredit”.

Ebru Süleyman: Për këtë më ka folur mua gjyshi, ai *han* paska qenë i babait të tij, aty ka punuar.

Mahmut Mumci: Po, është e mundur. Mbaj mend kur ishte aty *hani*, gjithashtu, mbaj mend që kishte një hyrje në *han* nga rruga “Bitli” {shpjegon me duar} derë me hark, hyrja ishte aty, dhe kishte një

⁶ Ndërtesë pranë udhës ose në qytete që shërbente si bujtinë për udhëtarët e që kishte edhe vend për kafshët e tyre.

hapësirë të madhe për veturat, njerëzit vinin aty të dielave me makinat e tyre. I kishte dy kate, kishte dhoma lart, dhe katet e poshtme përdororeshin si depo.

Prej *hanit* deri në rrugën Divan Jolli, dikur ka qenë një prodhues për fuçi, një zejtar që bënte fuçi. Po ashtu, kishim një mik nga shkolla me emrin Ibrahim, e quanim Kataroz, dyqani i tyre ishte dikur aty. Afër tyre ishte një qebatore. Nga rruga e vjetër e Çarshisë që shkon poshtë drejt rrugës së litarpunuesve, ka qenë një sinagogë, kështu që në Çarshi, edhe hebrejntë krahas turqve dhe shqiptarëve kanë pasur dyqane. Në atë kohë, ishin dy prodhues jorganësh, një orëtar dhe dy rrobaqepës që i mbaj në mend. Karakusheviq dhe Nashko kanë qenë orëtarë hebrej. Ishte edhe familja Piriçeviq që dikur ishin rrobaqepës. Ata ishin zejtarë në Çarshinë e Vjetër.

Ebru Süleyman: Ku saktësisht ka qenë sinagoga?

Mahmut Mumci: Eh, tash sinagoga, ju e dini sot ndërtesën e Kuvendit, prapa hyrjes ose hyrjes më të madhe të saj është atje, pikërisht përpara saj. Sinagoga nuk ishte kur ata shkatërruan atë zonë, sinagoga u zhvendos, dhe akoma qëndron deri në këtë ditë në vendin ku u zhvendos. Shtëpia e Eminxhikut, Muzeu Etnologjik i tanishëm, përpara atij muzeu, sinagoga është zhvendosur atje.

Ebru Süleyman: Dhe familjet hebreje, ata kanë ikur?

Mahmut Mumci: Familjet hebreje, bazuar në atë që unë di, kishte shumë familje këtu gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe ata u fshehën nga familjet e vjetra këtu në qytet gjatë atyre kohërave, i mbrojtën. Disa prej tyre u kapën nga pushtuesit gjermanë dhe u dërguan në kampe. Dhe më vonë, mendoj se pas vitit 1947, kur u krijua Izraeli, ata kanë lëvizur ngadalë atje. Mbaj mend drejtë mbi Taukbaççe, vendin e quajtur varrezë hebreje. Meqenëse nuk ishte shumë larg nga lagjja ime, shkonim atje shpesh. Ka qenë ndoshta, nuk e di numrin e saktë, por rreth dymbëdhjetë varre të mëdha, sarkofagë. Ne shkonim ngjiteshim mbi to, rrezitëshim të shtrirë, mbi gurë. Kishte simbole çifute dhe shkrime hebraike mbi to. Unë nuk e di nëse ky vend është ende atje, kam dëgjuar se kishin mbetur dy deri në katër varre dhe e kishin marr nën mbrojtje. Por unë nuk e kam parë që nga ajo kohë.

Ebru Süleyman: Ky Klubi i Boksit që është tani, çka ka qenë më parë aty?

Mahmut Mumci: Aty në periudhën e Serbisë, aty është një objekt që u ndërtua në periudhën e Mbretërisë Serbo-Kroate. Dhe aty është si një qendër sportive. Një vend për të zhvilluar lojëra të ndryshme sportive, u ndërtua si sallë sportive. Gjithashtu, pas luftës, pronari i rezidencës “Sokoli” ishte Klubi i Boksit i Prishtinës, ata i vazhduan ushtrimet aty. Gjithashtu Prishtina mori rezultatet më të mira në sportin e boksit. Mbaj mend që ka qenë Klubi “*Radnički*” [Srb.: i Punëtorëve] që ka pasur disa herë boksierë kampiona kur ka qenë Jugosllavia. Kishte disa boksierë të suksesshëm atje nga qendra e qytetit. Për shembull, Mehemet Ali Türbedar, İbuş Çolak. Ishte Birklaç në boks me peshë të rëndë nuk kishte njeri që mund ta mposhte, ai ishte me të vërtetë i suksesshëm.

Ebru Süleyman: Interesante domethënë boksi ka qenë sport i Prishtinës.

Mahmut Mumci: Rezultatet më të mira për boks kanë qenë në Prishtinë. Deri në vitet '50 - '60 - '70, ka qenë e suksesshme, atëherë në vitet '80-të, pati një periudhë regresioni. Pastaj në vitet '80 u krijua klubi i parë i mundjes. Edhe ata kanë përparuar shumë, edhe pse klubi i mundjes në Prishtinë kishte një kampion botëror në mundjen e lirë. Kemi pasur edhe një kampion mesdhetar. Unë kam njohuri për të gjitha këto sepse kam qenë një nga këshilltarët kur u krijua klubi. Unë madje u caktova në presidencë për dy mandate. Kjo ishte arsyeja pse kemi pasur rezultate kaq të shkëlqyera.

Ebru Süleyman: A jeni përleshur edhe ju?

Mahmut Mumci: Jo në përleshje unë vetëm në administratë (qesh), nuk isha aktiv, nuk e kam pamjen e një sportisti.

Pjesa e Dytë

Ebru Süleyman: Unë kam dëgjuar që ju keni qenë nxënës shumë i mirë në shkollë. Pastaj si morët vendim të studioni mjekësi? Kur e keni marr një vendim të tillë?

Mahmut Mumci: Është e vërtetë që kam qenë nxënës i mirë. E doja shkollën, e doja mësimin. Vetëm një mangësi, një të keqe e kisha, shkrimin e kam pasur shumë të keq (qesh). E sa i përket asaj pse jam bërë mjek arsyeja është një xhaxha që e kisha në shtëpi. Ai ishte i sëmurë rëndë prej tuberkulozit, në atë kohë nuk kishte ilaç për tuberkulozin, kështu që pacientët jetonin gjatë dhe dergjeshin në shtrat. Në shkollën e mesme, ne kishim një lëndë turke dhe mu kujtua se si ai vuajti shumë. Atë ditë kishim për ta shkruar një ese dhe tema ishte "Çka dëshiron të bëhesh?". Vetëm një gjë më shkoi ndërmend, doja të bëhesha mjek, kam shkruar për këtë dhe nuk kam ndryshuar më kurrë mendje.... Pas mbarimit të universitetit, kam punuar si mjek për 40 vjet në Prishtinë.

Ebru Süleyman: Në cilin universitet keni studiuar?

Mahmut Mumci: Unë universitetin e fillova në Beograd, të parin [vit], të dytin, deri të tretin kam studiuar në Beograd, pastaj u ktheva në Prishtinë.

Ebru Süleyman: Në atë kohë këtu u hap mjeksia.

Mahmut Mumci: Në të njëjtin vit kur u regjistrova në Beograd, u hap edhe në Prishtinë, por këtu u hap në dhjetor. Ndërsa unë u regjistrova në shtator në Beograd, kjo është arsyeja pse vazhdova atje. Ishte vërtetë bukur atje, dhe unë isha i suksesshëm edhe në Beograd.

Ebru Süleyman: Si ka qenë jeta atje, prej Prishtinës të shkosh në Beograd? Ai vend ishte më i madh...

Mahmut Mumci: Epo Beogradi ishte vërtet tërheqës dhe një qendër e madhe. Kishte vende të ndryshme për tu vizituar dhe parë, ishte vërtet bukur. Pastaj në vitin 1968 u zhvillua një demonstratë ndërmjet studentëve, kjo zgjati diku katër-pesë ditë...

Ebru Süleyman: A ishit ju aty?

Mahmut Mumci: Jo, ngjarja ndodhi në prill, unë shkova atje në shtator. Pas atyre ngjarjeve, pati shumë përpjekje pozitive në arsim, arsim universitar, veçanërisht për studentët e universitetit, ata bënë konvikte. Studentët kishin të drejta, për shembull, makinat që lëviznin në trafik i merrnin studentët kudo me një pagesë të vogël. Ata krijuan një nivel standard me cilësi vërtet të mirë.

Ebru Süleyman: Domethënë ju e arritët atë nivel.

Mahmut Mumci: Isha njëri prej të parëve (qesh), njëri prej përfituesve të situatës.

Ebru Süleyman: Domethënë tre vite keni jetuar në Beograd.

Mahmut Mumci: Po, në fakt dy vite, vitin e tretë pastaj [erdha] këtu.

Ebru Süleyman: A kishte aty studentë edhe prej vendeve të tjera të Jugosllavisë?

Mahmut Mumci: Ka pasur, atëherë në mjeksi kanë qenë deri 500 studentë. Prej këtyre 500 kishte prej secilit vend të Jugosllavisë. Në atë kohë në fakultetin e Beogradit ishim të regjistruar 50 studentë nga Kosova.

Ebru Süleyman: A njiheshit?

Mahmut Mumci: Njiheshim, kishim muhabet. Shiheshim, pastaj kishte shoqata.

Ebru Süleyman: A ishin edhe ata të Prishtinës?

Mahmut Mumci: Nuk ishin të gjithë nga Prishtina, ishin nga vendet e ndryshme të Kosovës, por disa prej tyre ishin nga Prishtina. Ishte Selahattin Kaykuş, ai ishte goran, unë shumë rrija me të. Kishte edhe disa njerëz të tjerë që unë i takoja, por më shumë rrinim bashkë me atë. Ishte Nusret, Nusret Ziyabeg dhe İskender Çitak që shkuan atje para meje. Gjithashtu është interesante që, kur shkova në Beograd, nuk e dija mirë shqipen, sepse në shkollë fisnim ose turqisht ose serbisht. Në lagjen tonë, ne nuk folëm gjuhë tjetër përveç turqishtes. Është interesante që pasi filloi emigrimi, familja e parë që u vendos në

lagjen tonë mësoi turqisht kështu që edhe ata filluan të flasin turqisht me neve. Kur u rrit numri i personave që migruan, gjithashtu u rrit edhe numri i njerëzve që u vendosën në lagjen tonë, kështu që filluam të mësojmë shqip. Unë bëja shaka dhe thosha se e mësova shqipen në Beograd, më pyesnin, “Si?” Dhe unë ju thosha se i kisha dy shokë dhome në konvikt dhe ata nuk flisnin as turqisht, as serbisht, kështu që (buzëqesh)ne duhej të flisnim shqip.

Ebru Süleyman: Në cilin vit thatë që jeni kthyer në Prishtinë?

Mahmut Mumci: Në Prishtinë u ktheva në vitin ‘72. 1972-tën.

Ebru Süleyman: Në ato vite Prishtina ka ndryshuar, është modernizuar më shumë.

Mahmut Mumci: Mbase viti ‘72 ishte koha më e ndritshme e Prishtinës që pas Luftës së Dytë Botërore. Ishte kështu me siguri për arsye politike, sepse në atë kohë kishte modifikime dhe ndryshime kushtetuese për të qenë më demokratik, dhe të gjithë filluam ta ndiejmë atë. Gjithashtu, si pakicë turke, ishte edhe koha jonë më e ndritshme. Është interesante që në njëfarë mënyre të drejtat që i kemi fituar në shtyp ishin arritje me të vërtetë të mira. Për shembull, e kishim gazetën tonë “Tan”⁷ transmetime në radio, madje kishim dy programe, programin e parë dhe programin e dytë. Kishte vetëm një të metë në këtë kohë, shqiptarët po na bënin presion duke thënë, “Mos shkoni në shkollat turke”. Në shkolla (buzëqesh), numri i stafit filloi të rritet, por numri i nxënësve u zvogëlua.

Ebru Süleyman: Pse të mos shkoni?

Mahmut Mumci: Kur nacionalizmi serb filloi të ulet, nga ana tjetër, një lloj tjetër nacionalizmi filloi të zhvillohej. Unë mendoj se ky nacionalizmi ndikoi negativisht në edukimin tonë.

Ebru Süleyman: Ndoshta kanë dashur që Kosova të tregojë më homogjene.

Mahmut Mumci: Ndoshta, mund të themi se ky ishte një lloj asimilimi. Kishte situata që bëhej presion. Nga ana tjetër, siç e përmenda, ne patëm mundësi të kishim një program në TV, në radio, të drejtat e shtypit, madje edhe për arsimin, disa libra u sollën nga Turqia ose u botuan këtu. Pastaj filluam bashkëpunimin me Turqinë lidhur me ngjarjet kulturore. Në vitet 1970, artistët vinin vazhdimisht, më kujtohet se të paktën një herë në muaj vinte një këngëtare apo një grup teatri. Ne kënaqeshim. Të gjithë artistët që i dinim, për të cilët kishim dëgjuar duke filluar nga Emel Sayin⁸ deri te Kadri Şarman⁹, artistë të ndryshëm ishin mysafirë këtu. Muazzez Abacı¹⁰, Kadri Şarman, Emel Sayin dhe kush tjetër

⁷ Gazeta e parë në gjuhën turke në Kosovë që për herë të parë u botua më 1 maj 1969 dhe u mbyll në vitin 1992

⁸ Emel Sayin (1945) Këngëtare dhe aktore e famshme turke.

⁹ Kadri Şarman (1943) Këngëtar i muzikës klasike turke.

¹⁰ Muazzez Abacı (1947) Këngëtare e muzikës klasike turke. Ajo është aktive që nga viti 1973.

ishte këtu, İnci Çayırılı¹¹, Barış Manço¹², Barış Manço erdhi më vonë, për më të rinjtë.

Ebru Süleyman: Duket sikur jeta kulturore ishte shumë vitale atëherë.

Mahmut Mumci: Po, po.

Ebru Süleyman: Madje nëse krahasojmë edhe më e gjallë se sot.

Mahmut Mumci: Ishte më e pasur. Ishte më e pasur dhe më e mrekullueshme, sepse artistët që vizitonin nuk vinin vetëm si person, por me gjithë ekipin e tyre. Ishte shumë e vështirë për të gjetur një vend të lirë për të shkuar në koncert ose nganjëherë disa kishin koncerte me ushqim në Hotel Grand ose në një vend të ngjashëm, dhe ishte shumë e vështirë për të gjetur biletë.

Ebru Süleyman: E në pushime a shkonit në atë kohë? Mendoj se kishte një liri më të madhe në Jugosllavi për të udhëtuar.

Mahmut Mumci: E vërtetë, ma përkujtuat tani që prej shkollës fillore kishte organizime për pushime prej komunës dhe prej Drejtorisë së Arsimit. Më kujtohet që për herë të parë kam shkuar një muaj për pushimë në Gërm, pas përfundimit të klasës së parë, por në atë kohë në Gërm ka pasur kamp me tenda. Shkonim herët në mëngjes, ktheheshim në mbrëmje. Të vegjëlit ktheheshin, por kush ishte më i madh qëndronte edhe natën sepse kishte tenda, por ne të vegjëlit ktheheshim. Kështu që, ky udhëtim që kishte filluar herët ishte një mundësi për pushime. Vitet e fundit, ne patëm mundësinë për të udhëtuar edhe në vende të tjera. Për shembull, kishte një zonë kampingu në Kaçanik, Brezovicë dhe në Deçan.

Pas kësaj, ata filluan të dalin jashtë në vende të tjera. Në atë kohë, si herën e parë, shkova në festën time të verës me organizata, dhe ishte viti 1957, dhe shkuam në Split, aty ishte një vend i quajtur Dugi Rat, prej këtu në stacionin e trenave të Prishtinës me dy karroca. Me atë tren shkuam gjithë rrugën në Split, dhe pas Splitit morëm anijen me avull për herë të parë, dhe gjithashtu pamë detin për herë të parë, dhe gjithashtu ishte hera e parë që ne ishim aq larg nga Prishtina. Kishte disa njerëz mes nesh që kurrë më parë nuk kishin qenë në tren. Dhe shkuam në atë vend, Dugi Rat afër Omish. Zgjaste një muaj atëherë. Pas kësaj, gjatë atyre viteve u ngrit një kampus në Pulla, dhe ne shkuam atje në Pulla.

Ndoshta ngjarjet më të lumtura të fëmijërisë sonë ishin këto udhëtime pushimi. Tradicionalisht atëherë, gjatë vitit të fundit të shkollës së mesme organizohej një turne për të udhëtuar në të gjithë Jugosllavinë, dhe ne udhëtonim. Madje më kujtohet, kur ne ishim në klasën e katërt të gjimnazit, gjendja financiare e shokëve të mi nuk ishte aq e mirë (buzëqesh). Nuk kishim kapital që të shkonim

¹¹ İnci Çayırılı (1935) Këngëtare e muzikës klasike turke.

¹² Barış Manço (1943-1999) Këngëtar turk i muzikës rock, tekstshkrues, kompozitor, aktor dhe producent i famshëm televiziv.

diku. Çfarë të bëjmë, si ta gjejmë një zgjidhje, mua mu kujtua, kisha dëgjuar që ishte njëfarë Abdüli, i cili punote në qendrën telefonike të spitalit, ishte mjeshtër i telefonave, i rregullonte lidhjet. Kisha dëgjuar prej tij se duhej të gërmohej një kanal për një kablo telefoni.

Pastaj u mendova a mund ta bënim ne këtë, ne ishim në formën më të mirë, ishim 17-18 vjeçarë. Shkova pastaj në klasë ju thashë kështu, “Unë po e gjej një punë, a pranoni edhe ju të punoni?” “Po”, tha dikush, dikush tha, “Jo”, pastaj unë thashë, “Prisni po shkoj unë ti pyes a na e japin ata neve këtë punë”. Në fund unë shkova në spital. Në spital e gjeta njëfarë Rrustem Statovci, ai ishte zyrtar për financa. Abdüli më dërgoi te ai. “Shiko”, tha, “bisedo me këtë njeri”. Pastaj hyra unë aty i tregova atij njeriut si është puna, “Kemi njohuri që juve po ju nevojitet dikush për ta hapur një kanal”. Kjo ishte atje ku është poliklinika, stomatologjia ku është tani, prej aty e deri te spitali i fëmijëve nevojitej hapja e një kanali, diku 150 metra.

“Kam dëgjuar” thashë, “ne jemi 24 persona që dëshirojmë të shkojmë në ekskurzion”, e nuk ishim aq, ishim 18 persona në klasë. I thashë, “Vetëm katër, pesë veta kanë mundësi të shkojnë, të tjerët nuk kanë para, nuk i kanë mundësitë”. Thashë, “Nëse keni mundësi të na ndihmoni do të ishte mirë. Ne do ta gërmojmë kanalin e ju na ndihmoni financiarisht”. U ndal më shikoi, “A mund ta bëni?” Thashë, “E bëjmë, patjetër që mundemi”. Pastaj edhe një person e mora unë, u bëmë disa veta. Atëherë në klasën tonë kishte mjaft të mëdhenj e të fuqishëm (buzëqesh), ishte Çamil Vlahinja, Emin Mecihan, Hamdi Begolli, Ibrahim, Mürteza, unë, Recep Şlek të gjithë, unë më i vogli isha. Shkuam vetëm të na shohin kush jemi, çka jemi.

Pastaj tham, “Shiko ne vijmë në mëngjes këtu, gërmojmë”, pasdite i kishim ligjëratat, “pasdite shkojmë në mësim”. Pastaj ka shkuar ka biseduar me drejtorin, në atë kohë ka qenë njëfarë Sogoviq, një mjek i famshëm i ka thënë, “Merri në punë ata”. Filluam me gërmimin e atij kanali, pothuajse një javë, dhjetë ditë punuam aty, 150 metër kanal. Shkonim me çanta me libra pastaj drejt e në shkollë. Tri, katër orë, shkonim gërmonim. Pastaj aty na dhanë, si sot më kujtohet 150.000 dinarë. Me vlerën e asaj kohe. E di se të gjithë që shkuam, tre veta nuk erdhën, prej 18 vetave 15, 16 veta punuam, i morëm nga dymbëdhjetë mijë dinarë secili. E për ekskurzion nevojiteshin nga 600 dinarë të paguajmë. E paguam dhe na mbetën para për të harxhuar. Kjo ishte një prej kujtimeve më të bukura, punuam, fituam, shkuam u shëtitëm, gjithë Jugosllavinë e vizituam, e pamë.

Ebru Süleyman: E në klasë i përmendët vetëm emrat e shokëve aty kishit edhe shoqe apo jo?

Mahmut Mumci: Jo, edhe vajzat i morëm të punojnë. Prej vajzave në klasë atëherë e kishim Aliye Muykon, e kishim Leman Safçin, e kishim Nermin Bayramin, e kishim İgbal Cinci, e kishim Cemile Mümin, e kishim Sebiha Hüdaverdi, Meliha Spahi, Nazan Geli, Nazan Kurteş. Kush tjetër? Ka qenë Beharja e Prizrenit, simpati e imja. Kë tjetër e kishim? Kështu 18 veta ishim aty.

Ebru Süleyman: Pastaj Jugosllavinë kur e vizituat me çka keni shkuar, me tren?

Mahmut Mumci: Me tren, me tren. Prej këtu shkuam në Beograd, u nisëm prej këtu në mbrëmje. Në mëngjes arritëm në Beograd. Në Beograd shëtitem gjithë ditën në “Tashmajdan”, në “Kalemegdan” në kopshtin zoologjik.

Ebru Süleyman: A ishte ajo hera e parë që keni shkuar në Beograd?

Mahmut Mumci: Jo, unë edhe më herët e kam pasur një rast dhe kam shkuar, e dija Beogradin. Para kësaj, në vitin 1963 kur isha në klasën e parë në gjimnaz, “A po shkojmë për pushime?” “Po shkojmë!” “Ku po shkojmë?” Një vit më parë ne ishim në Pulla, komuna na ka dërguar në Pulla. “Si të shkojmë?” Atëherë shkuam të gjithë, pesë shokë që rrinim bashkë, u regjistruam në Lidhjen Feriale¹³. I morëm librezat e shkollës, pastaj me librezat e gjetëm adresën e cila ishte “Banjola Vesalina” nr.6 (qesh) kjo ishte adresa e Lidhjes Feriale në Pulla. E bëmë një rezervim, e bëmë një parapagesë për të shkuar. Pastaj kishte zbritje 75 për qind për bileta. Pesë veta 14 - 15 vjeçar prej këtu deri në Pulla shkuam, e atëherë rruga i kishte 1500 kilometra. Pesë veta. Dy javë qëndruam atje pastaj u kthyem. Pastaj çdo vit shkonim në ndonjë vend tjetër, kur dilte vera bashkoheshim dhe shëtisnim falë Lidhjes Feriale.

Ebru Süleyman: E çka është ajo që thatë, ku jeni regjistruar?

Mahmut Mumci: Kështu i thoshin Lidhja Feriale si kjo shoqata për Udhëtime Verore, Feria...

Ebru Süleyman: Tani më s’ka...

Mahmut Mumci: Si Lidhja e Pushuesve, Lidhja e Shkrimtarëve, kështu diçka... për herë të parë kemi shkuar në vitin ‘63. Pastaj në vitin ‘64 u bë një koncert në Beograd, i thoshin “Ballkaniada”. Tanju Okan, Erol Büyükburç dhe Zaliha ishin tre artistë që e përfaqësuan Turqinë. Pasi shkuam në këto pushime, ne thamë, “A të shkojmë në Beograd për këtë koncert?” I kishim biletat nga Lidhja Feriale, i kemi blerë biletat dhe së bashku me shokët shkuam në Beograd. Udhëtuam gjatë gjithë ditës, natën shkuam në koncert, u mbajt në “Tashmajdan”. Ne u takuam me artistët nga Turqia. Edhe ata u befasuan, ishim të rinj turq në Beograd, atëherë ne ju sqaruam që nuk jemi nga Beogradi, por jemi nga Prishtina, kemi ardhur prej atje. Pastaj vonë natën, ne e morëm trenin përsëri për në Prishtinë, Fushë Kosovë.

Ebru Süleyman: E në atë kohë a e krahasoni Prishtinën me këto vendet tjera, a ishin ato vende shumë më ndryshe?

Mahmut Mumci: Po, në vitet e ‘70-ta Prishtina po zhvillohej me shpejtësi. Gjendja dhe pamja kishin ndryshuar shumë, gjithashtu ndërtimi i objekteve dhe krijimi i universitetit ishte një hap i madh. Kishte shumë përparim, i cili mund të shihej me sy të lirë dhe u vlerësua, pati përparim pozitiv,

¹³ Lidhja Feriale e Jugosllavisë ishte një organizatë që mbledhi të rinj, i edukoi ata, i dërgoi ata në punë dhe në udhëtime. Ishte një nga organizatat më të forta që siguronte shumëçka për të rinjtë.

sidomos pas këtyre modifikimeve politike. Më 1971, me modifikimet e kushtetutës, statusi politik i Kosovës u ndryshua nga krahina, në shtet. Ishte gati si republikë. Ne i kemi ndjerë ato zhvillimet pozitive. Siç thash, gjithçka ishte e mirë përveç që numri i studentëve po zvogëlohej në shkolla.

Ebru Süleyman: A ju kujtohet kur ka ardhur televizioni për herë të parë, apo kur kanë filluar të përhapen gjëra të tilla?

Mahmut Mumci: Eh kështu {bashkon duart} më kujtohet. Këtu në Prishtinë, ne shikuam programin e parë në vitin 1960. Rasti ishte që Roma, Italia po i mbante Lojërat Olimpikë. Ndeshja e futbollit ishte një nga lojërat për të cilën bënë një transmetim të drejtpërdrejtë. Në atë kohë, ishte një supermarket afër xhamisë së Çarshisë, tani aty është një zonë parkimi. Pronari i supermarketit ishte Rifat Macir. Nuk e di si e morri, nga e morri, por ai e vendosi një televizion për ta shfaqur ndeshjen. E vendosi satelitin në minaren e xhamisë, e ktheu satelitin nga Jastrebeci, dhe kishte qindra, ndoshta mijëra, njerëz që prisnin ta shikonin ndeshjen e futbollit. Në vitin 1960, televizioni i parë... pastaj brenda dy-tri viteve, u bë i përhapur dhe programet filluan të kishin më shumë cilësi. Filluan t'i ndërtonin stacionet e transmetimit, stacioni i parë i transmetimit u ndërtua te universiteti.

Ebru Süleyman: Para kësaj ishte radioja me siguri?

Mahmut Mumci: Po radioja.

Ebru Süleyman: A ju kujtohet edhe ndonjë gjë tjetër?

Mahmut Mumci: Këto po me kujtohen, nuk e di çka tjetër të shtoj...

Ebru Süleyman: Kur jeni njoftuar me tezën Resmiye?

Mahmut Mumci: Kur u ktheva nga Beogradi, e takova këtu, kur isha student. Marrëdhënia jonë filloi në vitin 1972 dhe u martuam '74-tën. Kur u martuam, ajo sapo u diplomua në universitet. Pas disa muajsh, diplomova dhe unë. Pastaj kemi gjithsej 85 vjet shërbim në kujdesin shëndetësor. Në kujdesin shëndetësor dhe në fushat e tjera, gjithmonë jemi munduar të jemi aktiv sa më shumë që të jetë e mundur. Ajo kishte një mundësi të shkëlqyeshme që të ishte drejtuese e një qendre shëndetësore në Prishtinë. Kam punuar si mjek kryesor te reparti i sëmundjeve të mushkërive për 30, madje 33 vjet, si mjek kryesor. 37 vite punova te reparti i sëmundjeve të mushkërive.

Pas luftës më të fundit, ne bëmë gjithçka mundëm në të gjitha aspektet. Ne ishim aktiv në partinë politike [turke]. Dhe pas kësaj pati një ofertë, në të vërtetë më erdhi një ofertë nga kryeministri i parë, kishte nevojë që njëri prej ministrave të ishte turk. Ishte e nevojshme që turqit [ta kenë një ministri] gjithashtu edhe pakicave tjera do t'ju jepnin disa ministri. Atëherë, ata kishin arritur një marrëveshje që të mos ketë dy ministra të pakicave që veprojnë në të njëjtin mandat, kështu që ata e ndanë

mandatin për një ministri, gjysmën e mandatit e kishin boshnjakët dhe gjysmën tjetër turqit. Boshnjakët sugjeruan një kandidat që u bë Ministër i Shëndetësisë, dhe si duket ata nuk bënë aq punë pozitive atje. Kështu që, ata u hoqën nga posti, në të vërtetë u hoqën menjëherë pasi filluan. Pas kësaj, automatikisht, ishte radha jonë.

Biseda shkoi andej dhe oferta më erdhi. Dhe unë thashë, “Nëse duhet të punoj vetëm në ministri zyrtarisht, mund ta pranoj, por nëse duhet të jem ministër dhe të punoj edhe disa punë të tjera, atëherë unë sugjeroj Resmijen sepse ajo ka më shumë përvojë në organizimin e punëve të tilla”. Në fakt, para luftës Shtëpia e Shëndetit i kishte 1500 punëtorë dhe më shumë se 200 mjekë, e ajo ishte drejtoreshë, ajo punoi si drejtoreshë për tre mandate atje. Ata e morën sugjerimin tim në konsideratë dhe Resmija u bë ministre, Ministre e Shëndetësisë.

Ebru Süleyman: E a ju kujtohet nëse shkojmë pak mbrapa, në vitin ‘70 apo ‘80 kur filluan demonstratat këtu? Cili vit ishte?

Mahmut Mumci: Po, ‘81-tën.

Ebru Süleyman: Në atë kohë a kishte kështu tension në përgjithësi?

Mahmut Mumci: Ka pasur. Atëherë serbët ishin çmendur bënë shumë presion. Shumë njerëz i hoqën nga pozitat. Këto ishin me të vërtetë periudha të vështira, por pikërisht atëherë, unë nuk isha këtu për shkak të specializimit tim. Unë isha në Zagreb për specializim dhe, rastësisht, Resmija u emërua në mandatin e saj të parë si drejtoreshë. Ajo kishte shumë vështirësi dhe unë sa herë që kisha mundësi vija për të parë çka po ndodh. Dëgjoja që ato ditë ishin ditë shumë të këqija. Nacionalizmi kishte arritur pikën kulminante, nacionalizmi serb.

Ebru Süleyman: Pastaj të ‘90-tat...

Mahmut Mumci: Kështu që në vitet e ‘90-ta, serbët i dëbuan të gjithë, ata i hoqën të gjitha të drejtat që shqiptarët i fituan. Ata bënë ndryshime në kushtetutë, në ato ndryshime ata praktikisht i mohuan të gjitha të drejtat e fituara. Njerëzit rezistuan, dhe ne rezistuam gjithashtu (buzëqesh), aq sa mundëm. Gjatë luftës, ne u detyruam të largoheshim dhe shkuam në Turqi, qëndruam atje për tre muaj. Ne patëm mundësinë për të qëndruar atje përgjithmonë, por nuk qëndruam, u kthyem.

Ebru Süleyman: Migrimi është i vështirë...

Mahmut Mumci: I vështirë...

Ebru Süleyman: Tani jeni në Prishtinë?

Mahmut Mumci: Tani jam në Prishtinë, kanë kaluar gjashtë vite që jam pensionuar nga puna ime, por nuk jam plotësisht i papunë. Një herë në javë shkoj në Qendrën Shëndetësore në Kaçanik si mjek konsulent. Shikoj rastet e sëmundjeve të mushkërive që nuk mund të diagnostikohen. Ndonjëherë më telefonojnë kur ju duhem, kur kanë nevoj për mua.

Ebru Süleyman: Ju falemnderit shumë, zoti Mahmut.

Mahmut Mumci: S'ka gjë.

Ebru Süleyman: Për të gjitha, për tregimet, kujtesën e keni të shkëlqyeshme, të gjitha na i treguat. Ju falemnderit për kohën.

Mahmut Mumci: S'ka gjë, unë njëkohësisht ju kërkoj falje sepse nuk bëra ndonjë përgaditje për këtë intervistë. Ndodhi ashtu diçka në shtëpi, nuk bëra dot asgjë se kam shumë fotografi në shtëpi dhe e kam pasur në mendje t'i sjell por nuk qenka e shkruar.

Ebru Süleyman: Nuk ka rëndësi. Herën tjetër.